



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001170/3

Tiranë ____ . ____ .2020

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave organizative për përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë, brenda standardeve, për personat me aftësi të kufizuar dhe moshën e tretë, në zyrën e "ALEAT", për aplikimin dhe pajisjen me karta ID dhe Pasaporta Biometrike.*

Drejtuar: **z.Haxhi MEMOLLA**
Kryetar i Bashkisë

RROGOZHINË

I nderuar z.Memolla,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në zbatim të detyrave dhe kompetencave të tij kushtetuese, ka nisur trajtimin me iniciativë të problematikës së përshtatshmërisë së ambienteve, ku zyrat e kompanisë "Aleat" ofrojnë shërbimet ndaj shtetasve.

Konkretisht, nisur nga publikimi në një media vizive¹, morëm dijeni se mjaft qytetarë kanë adresuar problemin e pamundësisë për ta kryer aplikimin për pajisjen me karta ID dhe Pasaporta Biometrike, pranë zyrave të "Aleat". Kjo pasi kanë ndeshur në mungesën e rampave të përshtatshme e të nevojshme për sigurimin e aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuar dhe të moshës së tretë.

Ndaj, me shkresën zyrtare, nr. K3/I40-4prot., më datë 18.12.2019, Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar për marrjen e një informacioni,

¹ oranews.tv

Kryetarëve të të gjitha bashkive në R.SH, lidhur me faktin nëse janë në dijeni të kësaj problematike të konstatuar si shqetësuese për shtetasit, si dhe për masat e ndërmarra për të përmbushur standardet e lëvizjes së lirë dhe ofrimit të këtyre shërbimeve, për kategorinë e PAK dhe Moshës së tretë.

Nëpërmjet shkresës me nr.71 prot., më datë 06.01.2020, Bashkia Rrogozhinë na ka informuar ndër të tjera se, “... *përsa i përket përshtatshmerisë dhe aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara dhe moshën e tretë*, zyra e Aleat nuk ka një ambient të përshtatshëm që përmbushin elementët e përshtatshmerisë dhe aksesueshmërisë, së duhur për marrjen e shërbimeve...”.

Në përputhje me funksionet dhe kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr.8454 datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit, e ka në fokusin e tij të punës edhe mbrojtjen e promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe moshës së tretë, të cilëve duhet t’u krijohen kushte të përshtatshme, për të lëvizur në mënyrë të pavarur dhe të marrin të gjitha shërbimet. Për këtë, të gjitha institucionet publike dhe ndërtesat private duhet të jenë të përshtatshme dhe të aksesueshme për këto kategori personash, me qëllim që të drejtat e tyre të mos cenohen dhe ata të ndihen të barabartë me pjesën tjetër të shoqërisë.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, përcaktohen masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjahen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

Sipas pikës 4 të Kreut I-rë, ky vendim e shtrin zbatimin mbi:

a) bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit të projekteve ndërtimore, si dhe të gjitha subjektet përgjegjëse për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara;

b) të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët.

Dispozitat e parashikuara në këtë vendim duhen zbatuar dhe të merren masa për përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë e duhur, brenda standardeve, për shërbimin e personave me Aftësi të Kufizuar, si dhe moshën e tretë, të cilët e kanë të pamundur marrjen e shërbimit, në rastin konkret, pajisjen me karta ID si dhe Pasaporta Biometrike.

Sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe në bazë të Nenit 21/b të Ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave për sigurimin e përshtatshmërisë dhe aksesueshmërisë brenda standardeve, për personat me aftësi të kufizuar dhe moshën e tretë, në zyrën e “ALEAT”, Bashkia Rrogozhinë, me qëllim marrjen e shërbimeve, për aplikimin dhe pajisjen me karta ID dhe Pasaporta Biometrike.

Për, sa më sipër, në bazë të nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lutemi në vijim të na informoni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi. Ky rekomandim është pjesë e raportimit periodik të institucionit të Avokatit të Popullit pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë sipas Vendimit nr.49/2017, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Mekanizmi për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, si dhe do të vlerësohet edhe nga grupi i ngritur për këtë qëllim nga Kryetari i Kuvendit.

Duke shpresuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R

Prof. As. Dr. Erjona BANA
(CANAJ)

